



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

**ASHNA**

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge

Air Navigation Services Agency

REPUBLIC OF KOSOVO		AGENCIJA ZA VAZDUŠNO NAVIGACIJSKE USLUGE	
REPUBLIKA KOSOVA		AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY	
RCP - REPUBLIC OF KOSOVO		SIN - NAVIGATION SERVICES AGENCY	
ZYRA E DREJTORIT KANCELARIA DREJTORIA OFFICE OF THE DIRECTOR			
Nr. fto: Ex. nr: Pg. nr:		15.03.24	
Nr. prot. D. prot. Prot. no	079	LP	LIPJAN, SKE

Letërpërcjellje

Data: 15.03.2024

<b>Për:</b>	Z. Samir Bllacaku
<b>Nga:</b>	Grupi Punues për Raportin Vjetor të Punës 2023
<b>Lënda:</b>	Raporti Vjetor i Punës 2023

**Përshkrimi i veprimit të kërkuar:**

Mbi bazën e vendimit të Drejtorit të ASHNA-së me Nr. 01/24, të datës 16/01/2024, përmes të cilit caktohet Grupi Punues për Hartimin e Raportit Vjetor të Punës 2023, Grupi dorëzon raportin sipas afatave dhe kriterëve të përcaktuara me këtë Vendim.

**Pala dërguese:**

Nënshkrimi:

Merita Makolli, Kryesues

Muhamet Islami, Anëtar

Ilir Dukolli, Anëtar

Data: 15.03.2024

**Pranohet:**

Nënshkrimi:

Data:

15.03.2024

**Nuk pranohet:**

Arsyetime:

Data:




RAPORT VJETOR I PUNËS 2023



# AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2023



**Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror**

**Vrellë, Lypjan, 10070, Republika e Kosovës**

**Tel: +383 38 59 58 100**

**Email: [info.ashna@rks-gov.net](mailto:info.ashna@rks-gov.net)**

**Uebfaqe: [www.ashna-ks.org](http://www.ashna-ks.org)**

## Përmbajtja

Përmbajtja.....	3
Mesazhi i Drejtorit.....	4
Historiku.....	5
Profili i kompanisë.....	6
Misioni dhe Visioni .....	7
Shërbimet Kryesore .....	8
Projektet dhe aktivitetet kryesore 2023.....	9
Funksionalizimi i rrugëve ajrore mes Kosovës dhe Shqipërisë .....	11
Struktura Organizative .....	14
Rrjedha e trafikut ajror.....	15
Operimet VFR.....	17
Komiteti për Buxhet dhe Siguri .....	19
Bashkëpunimi Ndërkombëtar .....	22
Koordinimi Civil-Ushtarak .....	23
Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë.....	24
Pasqyra e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës.....	25
Monitorimi i performancës .....	27
Arsyeshmëria për rritjen e ndodhive të raportuara.....	28
Menaxhimi i Cilësisë.....	30
Auditet e Jashtme .....	30
Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA).....	46
Menaxhimi i Rreziqeve të Organizatës .....	47
Burimet Njerëzore .....	48
Personeli i ASHNA-së .....	48
Profili i moshës së nëpunësit.....	49
Etniciteti i nëpunësve.....	49
Rekrutimi .....	49
Priroritetet për 2024.....	51

## Mesazhi i Drejtorit

*Të dashur punonjës, miq dhe bashkëpunëtor,*

*Kam kënaqësinë të ndaj me ju edhe këtë vit raportin vjetor të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës, përmes të cilit kemi shpalosur informacione kyçe të cilat pasqyrojnë punën tonë të përbashkët gjatë vitit 2023.*




*Gjatë vitit 2023 kemi operuar me kapacitete të plota dhe arritëm që me sukses të ofrojmë shërbim të pandërprerë 24/7, gjithmonë duke ruajtur nivelet më të larta të sigurisë së operimeve dhe gjithashtu duke i kushtuar vëmendje të vazhdueshme shëndetit dhe mirëqënies së personelit. ASHNA me sukses të plotë ka përmbushur detyrat e saj në arritjen e objektivave kryesore të sigurisë dhe krahas kësaj ka zhvilluar dhe implementuar projeksione të rëndësishme strategjike në funksion të përmirësimit të infrastrukturës dhe kapaciteteve njerëzore.*

*Përgjatë vitit 2023, ASHNA ka realizuar një sërë projektesh të rëndësishme të veçantë në ngritjen e kapaciteteve teknike dhe njerëzore për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror, duke veçuar edhe fillimin e projektit "Furnizimi, instalimi dhe operimi i Sistemit të Menaxhimit të Trafikut Ajror".*

*Vlerësoj përkushtimin maksimal të personelit dhe përkrahjen nga institucionet tona vendore dhe partnerëve tanë të çmuar, me të cilët në harmoni të plotë dhe të vazhdueshme bashkërenduam veprimet për normalizim të plotë të hapësirës së ulët ajrore, si dhe dizajnuam plane përkatëse për menaxhim të hapësirës së lartë ajrore të Kosovës.*

*ASHNA mbetet e përkushtuar në përmbushjen dhe arritjen e detyrave dhe objektivave të saj, duke garantuar siguri dhe cilësi për gjithë shfrytëzuesit e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës.*

Historiku



## Profili i kompanisë

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror është organizatë buxhetore e themeluar si agjenci e pavarur me Ligjin për Agjencinë e Shërbimit të Navigacionit Ajror 04/L-250 (publikuar në gazetën zyrtare nr.28, më 28.04.2014). Ligji ka filluar të implementohet më 01 janar 2016.

Me procesin e koncesionimit të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari" (prill 2011), shërbimet e navigacionit ajror mbetën jashtë projektit të koncesionimit, duke u organizuar dhe funksionuar për një periudhë kalimtare nën statusin e ndërmarrjes publike "ANP Adem Jashari"- Kontrolli Ajror.


ASHNA ofron shërbimet e navigacionit ajror të renditura në vijim, prej nivelit GND (tokë) deri në FL 205 (6250m) për të gjitha kategoritë e trafikut civil dhe ushtarak.

Veprimtaria e ASHNA-së përkufizohet në katër shërbimet kryesore në vijim. Puna e këtyre shërbimeve mbështetet nga shërbimet e çmuara administrative dhe financiare.

Duke qenë se siguria është objektiv dhe qëllim kryesor i ASHNA-së, sistemi i menaxhimit të sigurisë mbetet mekanizmi kryesor për ruajtjen, monitorimin dhe ngritjen e sigurisë.

- Shërbimet e Kontrollit të Trafikut Ajror
- Shërbimet e Informacioneve Aeronautike
- Shërbimet Meteorologjike dhe
- Komunikimi/ Navigimi/Vëzhgimi

ASHNA ka 162 të punësuar, kryesisht të shkolluar dhe përgaditur në institute te specializuara europiane.



## Misioni dhe Visioni

### Visioni

ASHNA do të jetë konkuruese në ofrimin e shërbimeve të navigimit ajror me efikasitetin më të lartë të kostos në rajon

### Misioni

Normalizimi dhe ofrimi i sigurt i shërbimeve të navigimit ajror për shfrytëzuesit e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës.



## Shërbimet Kryesore

ASHNA është e çertifikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës për shërbimet në vijim:

### Shërbimet e Trafikut Ajror

- Kontrolli i Trafikut Ajror (ATC)
- Shërbimi i Informacionit të Fluturimit (FIS)
- Shërbimi Këshillues për Trafikun Ajror
- Shërbimi i Alarmimit

### Shërbimet e Informacioneve Aeronautike

- Publikimi i Informacionit Aeronautik (AIP)
- Procesimi i NOTAM-ëve (NOF)
- Shërbimi raportues Aeronautik (ARO)

### Shërbimet Meteorologjike

- Parashikim
- Vrojtim

### Komunikimi/ Navigimi/Vëzhgimi

- Komunikim
- Navigim
- Survejim



## Projektet dhe aktivitetet kryesore 2023

Në funksion të përmbushjes së misionit dhe vizionit tonë, gjatë vitit 2023 kemi zhvilluar dhe realizuar disa projekte dhe aktivitete të rëndësishme kapitale, për të cilat kemi paraqitur në vijim përshkrimet përkatëse rreth rëndësisë dhe statusit të tyre.

Vlerësojmë t'i japim theks të veçantë projektit të **“Supply, installation and operation of the Air Traffic Management System 254-23-3743-2-1-1/C175.”** (Implementimi i Sistemit ATM).

**Projekti “Supply, installation and operation of the Air Traffic Management System 254-23-3743-2-1-1/C175.”**

Në fushën e navigacionit ajror, sistemi ATM (Air Traffic Management) është relativisht i gjerë dhe kompleks. Përveç faktorit njeri, ATM është elementi ndërlidhës i tërësisë së sistemeve.

Ky sistem nënkupton rrjete, pajisje softuerike/harduerike, të cilat mundësojnë ngritjen e kapaciteteve teknike të ASHNA-së për kontrollimin e hapësirës ajrore të Republikës së Kosovës, gjegjësisht hapësirën e ulët dhe të lartë ajrore.

Është esenciale që ASHNA të ketë kapacitetet e duhura teknike dhe njerëzore për t'a ofruar këtë shërbim.

Aktualisht, ASHNA është duke operuar me një sistem të vjetër ATM (instaluar në vitin 2004) dhe përveç faktit që sistemi është shumë i vjetër, mundësitë i ka shumë të kufizuara.



Si i tillë, mundëson kryerjen e punëve bazike, por nuk ofron mundësitë optimale për realizimin e objektivave tona.

Bazuar në Planin Kombëtar të Zhvillimit, si dhe në Planet e Biznesit të ASHNA-së, ky projekt është inicuar në vitin 2022, me titullin "Furnizimi, instalimi dhe funksionalizimi i sistemit për menaxhim të trafikut ajror". Për shkak të kompleksitetit dhe kostos, projekti ka qenë planifikuar të zhvillohet dhe të realizohet mes viteve 2022- 2025.

Përgjatë proceduarave të prokurimit/tenderimit, projekti është tenderuar tri herë (ritenderuar 2 herë) dhe rrjedhimisht kemi pasur vonesa në planin për implementimin e sistemit.

Në vijim do gjeni të përmbledhura pikat kyçe në këtë çështje.

- Projekti është inicuar në vitin 2022.
- Është tenderuar tri herë gjatë viteve 2022-2023
- Kontrata është nënshkruar në muajin gusht 2023
- Implementimi i projektit është duke u zhvilluar sipas planit dinamik dhe situacioneve (36 muaj)
- Ka përfunduar salla operative
- Projekti pritet të përfundojë në vitin 2026

Gjatë muajit Gusht 2023, projekti "Supply, installation and operation of the Air Traffic Management System" 254-23-3743-2-1-1/C175 ka filluar së zbatuari. Projekti si i tillë realizohet sipas afatave të përcaktuara në kontratë dhe si tërësi i ka katër shtylla:

Shtylla 1: Furnizimi, instalimi dhe operimi i sistemit për menaxhimin e trafikut ajror,

Shtylla 2: Furnizimi dhe instalimi i konsolova operuese,

Shtylla 3: Trajnimi i personelit për ACS (kontrollimi i trafikut ajrore në hapësirën e lartë ajrore),

Shtylla 4: Dizajni dhe rikonstruksioni i dhomes të kontrollit të trafikut ajror për shërbimet e ACC dhe APP.

### Shtylla 1:

Furnizimi, instalimi dhe operimi i sistemit për menaxhimin e trafikut ajror.

Në vitin 2023, ekipi i kontraktorit ka kryer dy vizita teknike në muajt Shtator dhe Nëntor 2023. Gjatë këtyre vizitave, ekipet teknike profesionale nga ASHNA janë përfshirë për të siguruar informacionin e nevojshëm për kontraktorin, me qëllim që të përfundojnë krijimin e Shqyrtimit të Dizajnit Paraprak (PCDR) dhe Shqyrtimit Kritik të Dizajnit (CDR) në lidhje me shërbimet në njësinë e Kullës. Për vitin 2024, pritet që të përfundojnë edhe PCDR dhe CDR për shërbimet e Approach dhe ACS.

PDR është inspektim formal i dizajnit për të siguruar që përmbush kërkesat dhe është në pajtueshmëri me kërkesat e subjektit që e kërkon, ndërsa CDR vlerëson që një produkt mund të hyjë në fazën e prodhimit dhe demonstrimit për të verifikuar që përmbush kërkesat, afatet, kostot dhe riskun.

### Shtylla 2:

Furnizimi dhe instalimi i konzollave operuese

Është përfunduar analiza si dhe përzgjedhja e dizajnit të konzollave operuese dhe instalimi pritet të përfundojë gjatë fazave në vijim.

### Shtylla 3:

Trajnimi i personelit për ACS.

Përgatitja për trajnimin e personelit për ACS (kontrollimi i trafikut ajror në hapësirën e lartë ajrore), është përfunduar në këtë fazë, duke u siguruar harmonizimi i hapësirës ajrore, procedurat, rrjedha e trafikut, si dhe të dhënat e nevojshme për trajnimin për ACS. Si pjesë e kontratës, është paraparë që të trajnohen 18 kontrollorë të trafikut ajror, të ndarë në tre grupe. Dy grupet e vitit 2024 do të fillojnë trajnimin në pranverë dhe vjeshtë të vitit 2024, ndërsa grupi i tretë do të fillojë trajnimin në pranverën e vitit 2025.

### Shtylla 4:

Dizajni dhe rikonstrukcioni i dhomes të kontrollit të trafikut ajror për shërbimet e ACC dhe APP. Projekti i renovimit të dhomës së kontrollit ACC/APP u krye me sukses, duke përfshirë dizajnin dhe rikonstrukcionin e dhomës për të përmirësuar infrastrukturën, kushtet e ndriçimit dhe akustikës. Kontraktori ofroi dizajnin për miratim dhe realizoi rikonstrukcionin sipas specifikave të kontratës, duke instaluar sistemin e ri HVAC dhe duke e ulur dyshemen. Kushtet e ndriçimit dhe akustikës u hartuan dhe realizuan për të siguruar një ambient pune të përshtatshëm, ndërsa sistemi i ri HVAC u përdor për të siguruar një klimë të përshtatshme. Gjithashtu, një sistem i mençur u instalua për të përmirësuar efikasitetin e dhomës, ndërsa një dhomë për bisedime u ndërtua për nevojat e takimeve dhe prezentimeve të ekipit. Projekti u përfundua brenda afatit dhe rezultoi me një ambient pune modern dhe funksional për personelin e kontrollit të trafikut ajror.



### **Çertifikimi dhe hyrja në funksion e Radarit MODE S/I në Gjakovë**

Gjatë periudhës raportuese është çertifikuar nga AACK radari i dytë MODE S/I në Gjakovë. Përmes instalimit të këtij radari janë eliminuar problemet me humbjen për disa sekonda të targetave të fluturakeve, reflektimit të targetave apo edhe duplikimit të targetave.

### **Zvogëlimi i ndarjes horizontale të fluturakeve nga 10NM në 5NM**

Gjatë periudhës raportuese, në bashkëpunim me AACK janë bërë të gjitha përgatitjet për të argumentuar benefitet e zvogëlimit të ndarjes horizontale ndërmjet fluturakeve nga 10NM në 5NM. Kjo arritje është realizuar me hyrjen në përdorim të radarit të dytë MODE S/I në Gjakovë. Me aplikimin e ndarjes 5NM, tani më kemi aplikim standard të ndarjes ndërmjet fluturakeve, arritje e cila do të ndikojë direkt në eliminimin e vonesave të fluturakeve, zvogëlimin e emetimit të CO2 si dhe lehtësimin e punës të kontrollorit.



### **Funksionalizimi i rrugëve ajrore Kosovës dhe Shqipërisë**

mes

Në kuadër të normalizimit të hapësirës së ulët ajrore, më 28 dhjetor është bërë hapja dhe funksionalizimi i rrugëve ajrore mes Kosovës dhe Shqipërisë. Për të mbështetur këtë normalizim, Shqipëria, përkatesisht autoritetet shqiptare patën vendosur dy pika të reja në hapësirën e vet ajrore, të quajtura ARBËR dhe KUKAD. Letër marrëveshja përkatëse për koordinim të trafikut mes dy njësive është lidhur dhe azhurnuar në vitet 2020 dhe 2022. Këto dy pika, për arsye përkatëse, deri në periudhën raportuese kanë pasur vetëm status "taktik" dhe rrjedhimisht nuk mund të integroheshin në Planet e Fluturimit. Në dhjetor të periudhës raportuese, me angazhimin e të gjitha palëve të interesit, ARBËR dhe KUKAD u funksionalizuan si pika të pranueshme në sistemet përkatëse të menaxhimit të rrjedhës së trafikut ajror europian. Më hapjen e këtyre pikave, përfitues të drejtëpërdrejtë janë shumica e kompanive ajrore që e kanë destinacion Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

### Sistemi i radiokomunikimit në Germi

Kontrata me numër identifikues 254-19-7084-1-1-5 e projektit të radio komunikimit në lokacionin e Gërmisë është nënshkruar me datë 23.12.2019 ndërmjet Agjencisë së Shërbimeve të Navigimit Ajror (ASHNA) dhe operatorit ekonomik Jotron AS, Norway, me qëllim të funksionalizimit të radiove të reja në atë lokacion.

Projekti "Supply, installation and commissioning of the radio communications system in Germi" është projekt në vetë që përfshin:

- Integrimin e sajtit të Gërmisë në dy VCS ekzistues (SITTI dhe Garex)
- Vendosjen dhe lidhjen e antenave me radio në lokacionin e Gërmisë
- "Upgrade" i RCMS duke përfshirë edhe sajtin e Gërmisë
- "Upgrade" i versionit paneleve emergjente (RRC) dhe integrim i sajtit të Gërmisë në to.
- Lidhja e radiove të Gërmisë në Richochet Recorder, për inxhizim.
- Vendosja e linjës dytësore me mikrovalë nga Gërmia në ASHNA.

Ky Projekt është finalizuar në fund të vitit 2023 dhe ka ndihmuar në përmirësimin e infrastrukturës së komunikimit Tokë – Ajër dhe si i tillë ka përmirësuar sigurinë e komunikimit. Ky lokacion pothuasje është kopje e lokacionit të Goleshit dhe kemi "Double Coverage" në shumë hapësira të operimit në Republikën e Kosovës.

### Sistemi i furnizimit me energji elektrike

Qëllimi i projektit "Sistemi i furnizimit me energji elektrike" ka qenë furnizimi me energji elektrike për sistemet/pajisjet e reja të cilat ishin paraparë të instalohen në hapësirën manovruese e poashtu edhe për pajisjet ekzistuese. Ky furnizim do të mundësohet nga objekti i ri i furnizimit me energji elektrike, i cili është ndërtuar si pjesë e këtij projekti. Një rol i rëndësishëm i këtij projekti është arritja e autonomisë së sigurimit të energjisë elektrike nga ASHNA dhe ngritja e nivelit të sigurisë në përgjithësi sa i përket furnizimit me energji elektrike në mungesë të furnizimit nga burimet e jashtme.

### Instalimi i kabllimit të rrjetit të energjisë dhe komunikimit në hapësirën manovruese

"Instalimi i kabllimit të rrjetit të energjisë dhe komunikimit në hapësirën manovruese", ka për qëllim furnizimin me energji elektrike për sistemet/pajisjet e reja të vendosura në hapësirën manovruese. Ky furnizim mundëson sigurimin e energjisë elektrike nga objekti i ri, i cili është ndërtuar si pjesë e këtij projekti deri tek sistemet/pajisjet në hapësirën manovruese. Po ashtu është vendosur sistemi i gjeneratorëve/UPS-ve, në lokacionet në të cilat janë vendosur sistemet/pajisjet. Ky sistem backup i furnizimit me energji elektrike është i pavarur nga sistemi i furnizimit nga objekti i ASHNA-së. Për jetësimin e projektit, është realizuar shtrirja e kabllimit të komunikimit për furnizim me energji elektrike dhe për komunikim mes lokacionit dhe objektit.

### Furnizim me pajisje për TI

Projekti "Furnizim me servera" ka pasur qëllim furnizimin, instalimin dhe konfigurimin e serverave dhe sistemeve aktuale të TI-së për të arritur një ambient më të sigurtë dhe virtual. Gjatë këtij projekti janë virtualizuar serverët dhe sistemet si dhe është krijuar një Sistem i Rimëkmbjes nga Fatkeqësitë i cili do të vendoset në hapësirën manovruese të ASHNA. Përveq pajisjes me teknologji të re që i përmbush kërkesat e ASHNA, me këtë projekt është siguruar vazhdimësia e punës (Business Continuity) të sistemeve të TI-së në rast të fatkeqësive. Ky projekt ka përfunduar në vitin 2023 dhe është funksional sipas kërkesave tona.




**Mbuloja e gjeneratorëve të Radarit në Gjakovë**

Është kryer me sukses aktiviteti Mbuloja e Gjeneratorëve në Gjakovë.

**Qasja rrugore në Radarin e Gjakovës**

Projektit “Qasja rrugore në Radarin e Gjakovës” ka përfunduar me sukses sipas afateve kohore.

### Struktura Organizative



### Rrjedha e trafikut ajror

Viti 2023 është shënuar me rritje të numrit të fluturimeve komerciale prej 6.8 %, që nënkupton 23082 operime ajrore komerciale, 1075 ushtarake dhe 2990 të tjera (GAT/VFR).

Të gjitha këto operime janë zhvilluar në përputhmëri të plotë me rregullativin vendor dhe ndërkombëtar.


Në vijim kemi paraqitur të detajuara raportet statistikore për çdo kategori trafiku ajror, duke i krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

#### Operimet komerciale

OPERIMET KOMERCIALE TE MENAXHUARA 2022- 2023			Krahasueshmëria	
Muaji	2022	2023	Nr. i operimeve	Përqindja
Janar	1587	1652	65	4.1%
Shkurt	1075	1231	156	14.5%
Mars	1361	1523	162	11.9%
Prill	1955	1988	33	1.7%
Maj	1861	2033	172	9.2%
Qershor	1976	2027	51	2.6%
Korrik	2668	2726	58	2.2%
Gusht	2602	2705	103	4.0%
Shtator	1837	2018	181	9.9%
Tetor	1700	1827	127	7.5%
Nëntor	1328	1453	125	9.4%
Dhjetor	1666	1899	233	14.0%
<b>TOTAL</b>	<b>21616</b>	<b>23082</b>	<b>1466</b>	<b>6.8%</b>

Tabela 1. Operimet komerciale gjatë vitit 2023 dhe krahasimi me vitin paraprak






### Operimet ushtarake


OPERIMET USHTARAKE TE MENAXHUARA 2022-2023	Krahasueshmëria			
	Muaji	2022	2023	Nr. i operimeve
Janar	94	111	17	18.1%
Shkurt	108	80	-28	-25.9%
Mars	120	99	-21	-17.5%
Prill	249	84	-165	-66.3%
Maj	151	98	-53	-35.1%
Qershor	150	115	-35	-23.3%
Korrik	117	103	-14	-12.0%
Gusht	87	102	15	17.2%
Shtator	144	104	-40	-27.8%
Tetor	107	59	-48	-44.9%
Nentor	90	59	-31	-34.4%
Dhjetor	129	61	-68	-52.7%
<b>TOTAL</b>	<b>1546</b>	<b>1075</b>	<b>-471</b>	<b>-30.5%</b>

Tabela 2. Operimet ushtarake gjatë vitit 2023 dhe krahasimi me vitin paraprak



**Operimet VFR**

Operimet VFR			Krahasueshmëria	
Muaji	2022	2023	N. I operimeve	Përqindja
Janar	246	319	73	29.7%
Shkurt	270	249	-21	-7.8%
Mars	246	288	42	17.1%
Prill	249	250	1	0.4%
Maj	245	383	138	56.3%
Qershor	272	338	66	24.3%
Korrik	282	268	-14	-5.0%
Gusht	248	171	-77	-31.0%
Shtator	326	108	-218	-66.9%
Tetor	418	268	-150	-35.9%
Nentor	275	191	-84	-30.5%
Dhjetor	278	157	-121	-43.5%
<b>TOTAL</b>	<b>3355</b>	<b>2990</b>	<b>-365</b>	<b>-10.9%</b>



## Komiteti për Buxhet dhe Siguri

Pëveç takimeve të rregullta të niveleve të ndryshme organizative brenda agjencisë, ASHNA ka zhvilluar edhe takimet e rregullta të Komitetit për Buxhet dhe Siguri. Gjatë vitit 2023, KBS ka mbajtur 5 takime, temat dhe vendimet e të cilave janë paraqitur në tabelën në vijim.

KBS është organi më i lartë brenda agjencisë, ku trajtohen çështjet e sigurisë dhe buxhetit.

Objektiv i Komitetit për Buxhet dhe Siguri të ASHNA-së është ofrimi i platformës për arritjen e objektivave të alokimit të resurseve dhe të vlerësojë efektivitetin dhe eficientëcnë e strategjive për zvogëlimin e rreziqeve. KBS është entitet strategjik dhe merret me çështje që kanë të bëjnë me politikën, alokimin e resurseve, monitorimin e performancës së organizatës dhe çështjet specifike të implementimit të SMS. Sapo të zhvillohet një strategji e drejtimit nga KBS, përmes menaxhmentit duhet të bëhet koordinimi i strategjive të sigurisë nëpër organizatë. Takime Ad hoc mund të thirren për diskutimin e çështjeve madhore siq janë aksidentet, incidentet serioze apo dukuritë tjera të sigurisë ose ndonjë ndryshim i rëndësishëm në praktikën e punës, dhe ato do të mbahen jo më vonë se një javë prej parashtrimit të një kërkesë të tillë. Artikujt e Agjendës, me pëlqimin e Kryesuesit, do të lëshohen normalisht jo më vonë se 7 ditë pas mbajtjes së takimit, dhe çështjet që nuk janë në agjendë do të konsiderohen në diskrecion të Kryesuesit. Sekretari i Komitetit do të shërbejë si mbajtës i procesverbalit. Drejtori i ASHNA-së mund të delegojë detyrat dhe përgjegjësitë e Kryesuesit të Komitetit te secili anëtar i KBS kur ai/ajo nuk është në dispozicion për kryesimin e takimit. Për më tepër, rregullimet e punës së KBS janë të specifikuar në Rregulloren mbi Organizimin dhe funksionimin e KCSSB të ASHNA.

Kushtet e referencës së KBS të përshkruara më poshtë janë të aspektit të sigurisë, kurse kushtet e përgjithshme të referencës janë të përshkruara në Rregulloren mbi organizimin dhe funksionimin e KCSSB të ASHNA.

- Rishikimi dhe propozimi i ndryshimeve në Politikën e Sigurisë, parimeve, dhe alokimi i përgjegjësive të sigurisë.
- Rishikimi i aktiviteteve të përmirësimit të sigurisë, raporteve të incidenteve serioze, dhe trendeve të incidenteve.
- Rishikimi i performancës së sigurisë dhe sigurimi që aktivitetet e korrigjimit dhe zvogëlimit janë ndërmarrë në kohën e duhur
- Rishikimi i efektivitetit të rekomandimeve të mëparshme të sigurisë
- Miratimi i treguesve të performancës së sigurisë dhe objektivave të performancës së sigurisë të përgatitura nga menaxheri i DCSS;
- Aprovimi i resurseve të përshtatshme për zbatimin e veprimeve që rrisin performancën e sigurisë
- Rishikimi vjetor i dokumenteve dhe manualeve të ASHNA-së
- Vlerësimi i ndikimit në siguri nga prezantimi i ndryshimeve operacionale apo teknologjive të reja
- Koordinimi i rezolutës së strategjive të zvogëlimit për pasojat e identifikuara të rreziqeve dhe sigurimi që ekzistojnë rregullime të kënaqshme për kapjen e të dhënave të sigurisë dhe reagimet nga personeli.
- Monitorimi i performancës së sigurisë kundrejt politikave dhe objektivave të sigurisë së organizatës
- Monitorimi i implementimit dhe efektivitetit të procesit SMS
- Monitorimi i efektivitetit të proceseve dhe procedurave të menaxhimit të sigurisë së organizatës
- Monitorimi i efektivitetit të mbikëqyrjes së sigurisë së organizatës nga palët e jashtme
- Mbikëqyrja e performancës operative të sigurisë brenda zonave funksionale në organizatë dhe sigurimi që janë kryer aktivitete të duhura për menaxhimin e rrezikut të sigurisë me përfshirjen e stafit aq sa është e nevojshme për ndërtimin e ndërgjegjësimit për sigurinë

## RAPORT VJETOR I PUNËS 2023

Nr.	Data	Tema
1	22.02.2023	<p><b>Mbledhja e Komitetit për Buxhet dhe Siguri - 38-të e KBS</b></p> <p><b>Agjenda:</b>                      Procesverbali i mbledhjes së 37-të të KBS-së. (Diskutim aprovim)                      Raportet vjetore të departamenteve për vitin 2022, (RVJ-2022). (Diskutim aprovim)</p> <p><b>Konkluzë:</b>                      Aprovohet Procesverbali i Mbledhjes së 37 (tridhjetë e shtatë) të KBS-së të mbajtur me datë: 27.12.2022.                      Aprovohen raportet vjetore të departamenteve për 2022, (RVJ-2022).</p>
2	02.05.2023	<p><b>Mbledhja e Komitetit për Buxhet dhe Siguri - 39-të e KBS</b></p> <p><b>Agjenda:</b>                      Procesverbali i mbledhjes së 38-të të KBS-së. (Diskutim aprovim)                      Raportet vjetore të departamenteve për Janar-Mars TM1. (Diskutim aprovim)</p> <p><b>Konkluzë:</b>                      Aprovohet Procesverbali i Mbledhjes së 38 (tridhjetë e tetë) të KBS-së të mbajtur me datë: 22.02.2023                      Aprovohen raportet e departamenteve për muajin Janar-Mars TM1-2023.</p>
3	25.07.2023	<p><b>Mbledhja e Komitetit për Buxhet dhe Siguri - 40-të e KBS</b></p> <p><b>Agjenda:</b>                      Procesverbali i mbledhjes së 39-të të KBS-së. (Diskutim aprovim)                      Raportet të departamenteve për Prill-Qershor TM2-2023 (Diskutim aprovim).</p> <p><b>Konkluzë:</b>                      Aprovohet Procesverbali i Mbledhjes së 39 (tridhjetë e nëntë) të KBS-së të mbajtur me datë: 02.05.2023                      Aprovohen raportet e departamenteve për muajin Prill-Qershor TM2-2023.</p>
4	09.11.2023	<p><b>Mbledhja e Komitetit për Buxhet dhe Siguri - 41-të e KBS</b></p> <p><b>Agjenda:</b>                      Procesverbali i mbledhjes së 40-të të KBS-së. (Diskutim aprovim)                      Raportet të departamenteve për Korrik-Shtator TM3-2023 (Diskutim aprovim).                      Caqet dhe treguesit kyç të performancës së sigurisë për vitin 2024.</p> <p><b>Konkluzë:</b>                      Aprovohet Procesverbali i Mbledhjes së 40 (dyzet) të KBS-së të mbajtur me datë: 25.07.2023.                      Aprovohen raportet e departamenteve për muajin Korrik-Shtator- TM3-2023.                      Aprovohen Caqet dhe treguesit kyç të performancës së sigurisë për vitin 2024.</p>
5	21.12.2023	<p><b>Mbledhja e Komitetit për Buxhet dhe Siguri - 42-të e KBS</b></p> <p><b>Agjenda:</b>                      Procesverbali i mbledhjes së 41-të të KBS-së. (Diskutim aprovim)                      Rishikimi i menaxhmentit                      Në kuader të rishikimit perfshihen pikat e mëposhtme:                      Rezultatet nga auditimet e brendshme;                      Auditet e Sigurise                      Auditet e Cilesise                      Auditet e NJAB                      Rezultatet nga auditimet tjera që i janë bërë ASHNA-s;                      Auditet e AAC-se                      Auditet e MPB-se                      Auditet e ZKA -                      Reagimi (<i>feedback</i>) i shfrytëzuesve dhe matja e kenaqshmerise;                      Performansa e proceseve dhe përshtatja e shërbimeve</p>

	<p>Gjendja e veprimeve korigjuese dhe parandaluese perfshire hazardet  Veprimet pasuese nga rishikimet e mëparshme të menaxhimit  Ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e menaxhimit të cilësisë  Rekomandimet për përmirësime  Aprovimi i planit të anketimeve të sigurisë për vitin 2024  Aprovimi i planit të auditeve të cilësisë për vitin 2024  Aprovimi i planit të auditeve të sigurisë për vitin 2024  <b>Konkluzë:</b>  Aprovohet Procesverbali i Mbledhjes së 41 (dyzet e një) të KBS-së të mbajtur me datë: 09.11.2023.  Aprovohet Rishikimi i menaxhimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Rezultatet nga auditimet e brendshme <ul style="list-style-type: none"> <li>- Auditet e Sigurisë</li> <li>- Auditet e Cilësisë</li> <li>- Auditet e NJAB</li> </ul> </li> <li>• Rezultatet nga auditimet tjera që i janë bërë ASHNA-s <ul style="list-style-type: none"> <li>- Auditet e AAC-se</li> <li>- Auditet e MPB-se</li> <li>- Auditet e ZKA</li> </ul> </li> <li>• Reagimi (feedback) i shfrytëzuesve dhe matja e kenaqshmerisë;</li> <li>• Performansa e proceseve dhe përshtatja e shërbimeve</li> <li>• Gjendja e veprimeve korigjuese dhe parandaluese perfshire hazardet</li> <li>• Veprimet pasuese nga rishikimet e mëparshme të menaxhimit</li> <li>• Ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e menaxhimit të cilësisë</li> <li>• Rekomandimet për përmirësime.</li> </ul> <p>Aprovohet plani i anketimeve të sigurisë për vitin 2024  Aprovohet plani i auditeve të cilësisë për vitin 2024  Aprovohet plani i auditeve të sigurisë për vitin 2024</p>
--	--

## Bashkëpunimi Ndërkombëtar

### Vizita në BULATSA

Me ftesë të Bulgarian Air Traffic Services Authority një delegacion i ASHNA, në të cilën DATS ka qenë i përfaqësuar nga UD i Menaxherit të DATS ka marrë pjesë në këtë takim, i cili është mbajtur gjatë muajit qershor në Sofje, Bullgari. Kjo vizitë është realizuar në kuadër të Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet ASHNA-BULATSA, të nënshkruar në vitin 2017. Kjo vizitë ka qenë kryesisht e karakterit profesional dhe në të njëjtën kohë ka shërbyer që të shkëmbejmë kontakte dhe të njihemi nga afër me kushtet dhe mundësitë që BULATSA mund t'i ofrojë ASHNA-së përbrenda fushëveprimit të bashkëpunimit. Për më shumë, kjo vizitë është shfrytëzuar për të arritur marrëveshje që në vitin 2023, BULATSA t'i ofrojë DATS trajnimin rifreskues për APS/APP të kontrollorëve të trafikut ajror.



### Vizita në Panairin e Aviacionit në Gjenevë

Në mënyrë që të njoftohemi me më të rejat nga fusha e aviacionit, DATS i përfaqësuar nga UD i Menaxherit të DATS ka marrë pjesë në këtë panair, i cili është mbajtur gjatë muajit mars në Gjenevë, Zvicërr. Kjo vizitë ka qenë e karakterit profesional dhe në të njëjtën kohë ka shërbyer që të shkëmbejmë kontakte me shumë kompani prestigjioze të aviacionit. Për më shumë, kjo vizitë është shfrytëzuar që të sigurojmë kontakte me disa institute të trajnimit me të cilët besojmë që do të lidhim ura të bashkëpunimit në të ardhmen.

## Koordinimi Civil-Ushtarak

### Krijimi i shërbimit meteorologjik/aeronautik ushtarak në Aeroportin e Gjakovës

Me iniciativë të ushtrisë amerikane në Kosovë, ka filluar themelimi i njësisë së shërbimit meteorologjik ushtarak, dedikua për Aeroportin e Gjakovës.

Siç edhe e dimë, ky aeroport është në menaxhim nga Ministria e Mbrojtjes së Kosovës dhe shfrytëzohet nga Forca e Sigurisë së Kosovës.

ASHNA, me kapacitete profesionale, ka kontribuar në identifikimin dhe zhvillimin e draft- projektit për themelimin dhe funksionalizimin e kësaj njësie. Gjithashtu, FSK është asistuar edhe në identifikimin e nevoja teknike dhe njerëzore për realizimin e këtij projekti.

Është dakorduar që ASHNA të përkrahë FSK-në edhe me trajnime, në përgatitjen e personelit ushtarak, për fushën e meteorologjisë aeronautike.

### Identifikimi i poligoneve private të qitjes

Në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, ASHNA ka marrë pjesë në takime dhe aktivitete përkatëse për identifikimin e poligoneve private të qitjes në Kosovë. Gjithashtu janë bërë vlerësime mbi impaktin e këtyre poligoneve në rrjedhën e trafikut ajror në Kosovë.





## Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë

ASHNA duke zbatuar procedurat e Manualit për Menaxhimin e Sigurisë, Cilësisë dhe Sigurimit ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e parapara në Planin e Punës për vitin 2023.

Viti 2023 është karakterizuar me proceset e implementimit të sistemeve/pajisjeve të reja në kuadër të projektit për zgjatjen dhe ngritjen e kapaciteteve të pistës, që pashmangshëm është kërkuar një angazhim dhe përkushtim i stafit të ASHNA-se në mënyrë që ky projekt të realizohet në përputhje me standardet e sigurisë, cilësisë dhe sigurimit, në fushën e menaxhimit të ndryshimeve.

Natyrisht sfida të cilat lidhen me menaxhimin e ndryshimeve, trajtimin e ndodhjeve dhe hazardre, hetimet e sigurisë janë menaxhuar me angazhimin e përbashkët të të gjithë personelit të ASHNA-së dhe me krijimin e një kulture pozitive të sigurisë .

Duke u mbështetur në kapacitetet profesionale dhe vullnetin tonë të përgjithshëm, duke respektuar normat dhe procedurat perkatese të funksionimit përmes veprimeve proaktive dhe reaktive , ASHNA ka arritur të mbajmë një klimë pozitive të sigurisë, ku i gjithë personeli i ASHNA-së - ndihet përgjegjës, duke konsideruar çdo ndikim të mundshëm, me qëllim që shërbimet të cilat ofrohen nga ASHNA, të jenë në përputhje me standardet e kërkuara.

### "Just Culture"

Çelësi për zbatimin e suksesshëm të rregulloreve të sigurisë është të arrihet një mjedis raportimi "JUST CULTURE" brenda organizatave të aviacionit, rregullatorëve dhe autoriteteve të hetimit. Kjo kulturë efektive e raportimit varet nga mënyra se si organizata trajton fajin dhe ndëshkimin.


Koncepti "JC" ka për qëllim që të zhvillohet një kulturë në të cilën operatorët e linjës së parë dhe të tjerët nuk ndëshkohen për veprime, mosveprime ose vendime që kanë marrë dhe që janë në përpjesëtim me përvojën e tyre dhe trajnimin, ndërkohë që neglizhenca e rëndë, shkeljet e qëllimshme dhe aktet shkatërruese nuk tolerohen.

Në vazhden e ngritjes së kësaj kulture, gjithnjë në interes të ngritjes së nivelit të sigurisë dhe adaptimit të rregulloreve të BE-së, ASHNA ka implementuar "JUST CULTURE" si pjesë e Menaxhimit të Sigurisë.




Pasqyra e performansës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performansës


Hazardet e raportuara – Periudha 01 Janar – 31 Dhjetor 2023					
Muaji	DATS	DTEK	DMET	DAIS	TOTAL/MONTH
Janar	0	9	11	0	20
Shkurt	0	10	17	0	27
Mars	6	8	10	0	24
Prill	21	5	4	0	30
Maj	11	8	3	0	22
Qërshor	9	21	12	0	42
Korrik	12	14	18	0	44
Gusht	20	5	10	0	35
Shtator	25	4	9	0	38
Tetor	12	4	21	0	37
Nëntor	15	2	25	0	42
Dhjetor	9	0	15	0	24
<b>TOTALI</b>	<b>140</b>	<b>90</b>	<b>155</b>	<b>0</b>	<b>385</b>



### Hazardet e raportuara sipas muajve Periudha 01 Janar – 31 Dhjetor 2023



### Raportimet sipas departamenteve



Monitorimi i performancës

	Indikatori	Totali 2023	Totali 2022	Treguesi i sigurisë	Caqet e performancës së sigurisë për vitin 2023
1	Incidentet me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM)	8	8	Numri i incidenteve me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror (ATM)	Numri i incidenteve me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 incidente në vit.
2	Dështimi i funksionit të Navigimit	9	4	Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksionit të Navigimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 4 dështime në vit.
3	Dështimi i funksionit të Survejimit	7*	0	Numri i dështimeve të funksionit të Navigimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksionit të Survejimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 3 dështime apo 80 orë në vit, përfshi këtu edhe ndërprerjet për mirëmbajtje të planifikuar
4	Dështimi i funksionit të Komunikimit	20	24	Numri i dështimeve të funksionit të Komunikimit me ndikim të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksionit të Komunikimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 dështime në vit.
5	Dështimi i funksionit ndihmës të informimit	32	49	Numri i dështimeve të funksionit Ndihmës të informimit duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksionit të funksionit ndihmës të informimit me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 20 dështime në vit.
6	Dështimi i funksioneve të procesimit të të dhënave	83	51	Numri i dështimeve të funksionit procesimit të të dhënave duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksionit të Procesimit të të dhënave me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 30 dështime në vit.
7	Të tjera	0	6	Numri i dështimeve tjera duhet të zvogëlohet	Numri i ndodhjeve të dështimit të funksioneve tjera me ndikim në ofrimin e Shërbimit të Menaxhimit të Trafikut Ajror duhet të mbahet sa më ulët që është praktikisht e arsyeshme, apo jo më shumë se 10 në vit.
<b>Totali</b>		<b>159</b>	<b>142</b>		

**Caqet dhe treguesit kyç të performancës së Sigurisë për vitin 2023**

**Krahasimi i treguesve të performancës 2016 – 2023**

Nr	Indikatori	2023	2022	2021	2020	2019	2018	2017	2016
1	Incidentet me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM)	8	8	6	0	7	7	7	5
2	Dështimi i funksionit të Navigimit	9	4	8	4	2	2	2	1
3	Dështimi i funksionit të Survejimit	7	0	19	7	18	5	1	20
4	Dështimi i funksionit të Komunikimit	20	24	32	19	11	9	14	6
5	Dështimi i funksionit ndihmës të informimit	32	49	17	13	23	35	24	16
6	Dështimi i funksioneve të procesimit të të dhënave	83	51	20	9	9	5	7	10
7	Të tjera	0	6	7	6	4	2	7	5
<b>TOTALI</b>		<b>159</b>	<b>142</b>	<b>109</b>	<b>58</b>	<b>74</b>	<b>65</b>	<b>62</b>	<b>63</b>

**Arsyeshmëria për rritjen e ndodhive të raportuara**

Nga tabela e caqeve dhe treguesve kyç të performancës së sigurisë për vitin 2023 (aneksi 01 i këtijë raporti), vërehet se në kategorinë C ka rritje në numrin total të raportimeve në krahasim me vitet paraprake apo i kanë tejkaluar caqet e planifikuara. Në kategorinë D të raportimeve në krahasim me vitin paraprak gjithashtu vërehet rritje në krahasim me vitin e kaluar.

Në fushën e **funksionit të navigimit**, ka rritje në krahasim me vitin paraprake dhe është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar. Ndodhitë në këtë fushë kanë të bëjnë me reshjet e bores, ku pajisjet e navigimit janë mbuluar nga bora dhe deri në pastrimin e tyre kanë qenë në alarm.

Në fushën e **funksionit të survejimit**, ka rritje në krahasim me vitet paraprake dhe është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar sa i përket numrit të dështimeve, mirëpo me orë pune nuk është kaluar caku.

Në fushën e **funksionit të komunikimit**, ka rënie nga viti paraprak, mirë është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar. Pas instalimit të sistemeve të reja të radiove në Golesh dhe ASHNA është instaluar edhe një sistem i ri në Germi. Rritja er numrit të ndodhive është arsyetuar me stabilizimin e pajisjeve të reja pas instalimeve fillestare.

Në fushën e **funksionit ndihmës të informimit**, ka rënie në krahasim me vitin e kaluar, mirëpo është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar. Ndodhitë kryesisht kanë të bëjnë me sistemet e reja meteorologjike, të cilat sipas

prodhuesve duhet pak kohë deri në stabilizimin e tyre, përfshirë këtu dhe sistemet e parashikimit të cilat kanë pësuar rënie edhe për shkak të ndërprerjeve në rrjetin e internetit.

Në fushën e funksionit të procesimit të të dhënave, ka rritje në krahasim me vitet paraprake dhe është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar. Në këtë fushë gjendja është jo e mire, sistemi ATM është i vjetër (i instaluar në vitin 2004) dhe ka vështirësi në procesim të të dhënave. Për më shumë, rritja gjithnjë e më e madhe e trafikut ajror, po e vështirëson edhe më shumë procesimin e të dhënave. Si rrjedhojë e kësaj kanë ndodhur restartime të pozitave operuese duke shkaktuar humbje të fotografisë së radarit si dhe humbje dhe devijime të objekteve në radar (radar targets). Në lidhje me këtë çështje, DCSS së bashku me DATS, kanë realizuar një vlerësim të sigurisë në vitin 2021 për t'u siguruar që performanca e sigurisë së operimeve, në ASHNA nuk do të ndikohet gjatë ofrimit të shërbimeve radarike.

ASHNA është në process të prokurimit të një sistemi të ri ATM dhe nëse gjithçka shkon sipas planifikimeve, brenda 3 viteve sistemi i ri do të instalohet. Në ndërkohë, janë duke u bërë përpjekje maksimale për mbajtjen në funksion të sistemit aktual. Duhet theksuar se pas disa intervenimeve të bëra, në pjesën e dytë të vitit dështimet kanë rënë dukshëm.

Në fushën e Incidenteve me ndikim të Menaxhimit të trafikut ajror (ATM) numri i ndodhjeve në krahasim me vitin e kaluar është 1 njejtë, mirëpo nuk është tejkaluar caku i performancës së përcaktuar. Në këtë fushë, në rritje të numrit të ndodhjeve ka ndikuar edhe një dukuri e shfaqur në vitin 2022, ajo e kërcënimeve me bombë, të cilat për fat të mirë kanë rezultuar të jenë alarme të rrejshme si dhe 2 ndodhi që nërlidhen me humbje të seperimit.

Duhet theksuar se edhe ngritja e nivelit të vetëdijësisë të personelit për raportime, duke pasur parasysh angazhimin e menaxhmentit në fuqizimin e "No Blame Policy" dhe prezentimin e "Just Culture", ka ndikuar në rritjen e raportimeve, gjithmonë në funksion të identifikimit dhe përmirësimit të zbrastësirave të mundshme, si dhe ngritjes së kapaciteteve, me qëllim të ngritjes së nivelit të përgjithshëm të sigurisë

Të gjithë objektivat e indikatorëve kyç të performancës (KPI) të përcaktuara në planin e performancës për vitin 2023 janë përmbushur dhe tendencat në treguesit e performancës që po monitorohen janë pozitive.

## Menaxhimi i Cilësisë

ASHNA ka implementuar Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë (SMC) dhe është në proces për t'u çertifikuar në përputhje me kërkesat e standardit ndërkombëtar ISO 9001:2015.

ISO 9001:2015 SMC ndihmon në përmirësimin e performancës së përgjithshme dhe ofron një bazë solide për zhvillim të qëndrueshëm.

Cilësia e shërbimeve që ofron ASHNA, është e garantuar nga një grup i kontrollave dhe kontrollon nga menaxhmenti kompetent i projekteve, personat e autorizuar të cilit janë pjesë e proceseve të trajnimit dhe të zhvillimit të sistemit. Gjithashtu, cilësia e garantuar e shërbimeve i nënshtrohet kontrollave të rregullta të zhvillimit të dokumenteve të brendshme si dhe mirëmbahet pajtueshmëria e tyre me normat tjera aplikative.

Gjatë periudhës nën raportim, kontrolla e cilësisë është bërë gjithashtu edhe përmes auditimeve të brendshme të cilat kanë ndihmuar në rishikimin e proceseve si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tyre.

Përveq mirëmbajtjes së sistemit ekzistues të Menaxhimit të Cilësisë, ASHNA gjatë vitit ka bërë progres në përgatitje për të siguruar çertifikimin me ISO 9001:2015, finalizimi i të cilit planifikohet të arrihet gjatë vitit 2024.

## Auditet e Jashtme

Janë realizuar auditet e rregullta të AAC-së në periudhat:

27-31 Mars 2023

17-21 Korrik 2023

19 Nëntor 2023, audit i përbashkët i realizuar me ICETRA. Për këtë qëllim janë kordinuar dhe plotësuar pyetësorët e dërguar nga ICETRA për auditin e planifikuar në ASHNA

Një audit ka qenë i planifikuar të zhvillohet në tetor 2023, por për shkak të vizitës së Islandezëve dhe auditit të përbashkët AAC-ICETRA është shtyrë dhe nga AAC është planifikuar të realizohet javën e tretë të dhjetorit, respektivisht nga 18 deri më 22 dhjetor 2023.

Për shkak të angazhimeve të shumta në muajin dhjetor kemi kërkuar që ky audit të shtyhet për vitin 2024.

Duke marrë parasysh që ICETRA ka bërë vlerësim të situatës edhe në ASHNA e edhe në AAC përmes auditimeve "desktop" dhe "on sight" për dy muaj me radhë (tetor dhe nëntor 2023), AAC ka pranuar kërkesën tonë për shtyrjen e këtij auditit për vitin 2024.

Nga të gjitha auditet e realizuara viteve paraprake e deri më sot, 8 gjetje/observime mbeten të hapura dhe pritet të mbyllën gjatë vitit 2024 me përjashtim të njëjës e cila ndërlidhet me sallën e re të kontrollit. Këtu nuk janë paraqitur gjetjet e auditit të përbashkët nga AAC dhe ICETRA pasi që raporti final është pranuar në shkurt 2024.

### Konsultimi me Shfrytëzuesit e Shërbimeve dhe Matja e Kënaqshmërisë

Duke u bazuar në Nenin 16, Paragrafi 1.12 i Ligjit Nr. 04/L 250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si të Rregullores Nr. 7/2012 të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës mbi Kushtet për Ofrimin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, më 08 dhjetor 2023, është zhvilluar një takim konsultativ me shfrytëzuesit e shërbimeve tona. Ky takim zhvillohet në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve tona, duke ndarë me shfrytëzuesit e shërbimeve informacione për planet zhvillimore të ASHNAs dhe për adresimin e çdo çështjeje me interes.

Po ashtu, në mbështetje të nenit 16, përkatësisht pikës 1.8, 1.12 dhe 1.13 të Ligjit për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), kemi zhvilluar një anketim për matjen e Kënaqëshmërisë së Konsumatorit me Shërbimet e ASHNA-së për vitin 2023. Nga ky anketim rezulton se shfrytëzuesit e shërbimeve janë shumë të kënaqur me shërbimet e ASHNA-së.





## Performanca Financiare

Nr	Muaji	Realizimi 2023	Realizimi 2022	ndryshimi	ndryshimi ne %
1	Janar	1,086	1,023	63	5.82%
2	Shkurt	807.8	695.3	113	13.93%
3	Mars	978.69	877.31	101	10.36%
4	Prill	1,310.99	1,258.94	52	3.97%
5	Maj	1,287.87	1,182.11	106	8.21%
6	Qershor	1,337.25	1,264.18	73	5.46%
7	Korrik	1,805.34	1,738.43	67	3.71%
8	Gusht	1818.33	1,691.65	127	6.97%
9	Shtator	1354.46	1,193.02	161	11.92%
10	Tetor	1,217.25	1,038.59	179	14.68%
11	Nentor	973.64	862.04	112	11.46%
12	Dhjetor	1,284.77	1,089.16	196	15.23%
<b>Totalet</b>		<b>15,263</b>	<b>13,913.73</b>	<b>1349</b>	<b>8.84%</b>

Në vitin 2023, ASHNA ka pasur ngritje të theksuar të njësive terminale të shërbimit krahasuar me vitin 2022 në lartësi prej 8.84%.

Gjatë vitit 2023 janë ofruar gjithsej 15,263 njësi shërbimi.

## Kostoja e njësisë

Llogaritja e kostonë së njësisë terminale të navigacionit (TNC) për vitin 2023 ka rezultuar nga zbatimi i metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren nr. 3/2016 të AAC-së mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror. Bazuar në këtë metodologji, TNC llogaritet për vitin "n" në bazë të kostove dhe trafikut të vlerësuar për atë vit.

Kostoja e njësisë në vitin 2023 ka qenë 380 Euro.

## Deklarata

Pasqyrat financiare të cilat janë të bashkangjitura, përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023, janë përgatitur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik të vitit 2017 "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme", i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-221, Ligjin nr. 04/L-116, Ligjin nr. 04/L-194, Ligjin nr. 05/L-063 dhe Ligjin nr. 05/L-007 dhe janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kjo deklaratë jepet në lidhje me prezantimin e Pasqyrave Financiare të organizatës buxhetore për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 dhe është pjese përbërëse e pasqyrave financiare.

Ne besojmë dhe konfirmojmë, që:

- Nuk ka pasur parregullsi lidhur me udhëheqësin apo me punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.
- Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me burimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës janë të plota dhe të sakta.
- Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave janë të sakta.
- Nuk ka tjera llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2023.
- Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të autoriteteve rregullatore të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare.
- Nuk ka ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare
- Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe kontingjente, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur në mënyrën e duhur.
- Të gjitha huat e pranuar janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas legjislacionit në fuqi
- Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare që janë të bashkangjitura paraqesin një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të financave dhe transaksioneve financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023 të institucionit Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Planifikimi dhe realizimi i të hyrave

Të hyrat nga ofrimi i shërbimeve terminale ("Approach fee")

Nr	Muaji	Planifikimi 2023	Realizimi 2023	Ndryshimi
1	Janar	364,588.53	412,800.28	48,211.75
2	Shkurt	459,437.64	306,952.30	-152,485.34
3	Mars	390,273.80	369,933.20	-20,340.60
4	Prill	300,322.55	498,190.92	197,868.37
5	Maj	329,198.06	489,390.86	160,192.80
6	Qershor	395,307.88	508,175.28	112,867.40
7	Korrik	437,703.99	686,104.02	248,400.03
8	Gusht	471,219.48	690,921.13	219,701.65
9	Shtator	746,215.94	514,707.69	-231,508.25
10	Tetor	795,109.87	462,555.05	-332,554.82
11	Nentor	494,142.71	369,982.55	-124,160.16
12	Dhjetor	436,711.13	488,209.37	51,498.24
	<b>Totali</b>	<b>€ 5,620,231.58</b>	<b>€ 5,797,922.65</b>	

TRANASKIONET E LLOGARISË SË ASHNA-SË NË BQK

- Të hyrat e përgjithshme

Të hyrat nga shitja e shërbimeve Aproach Fee	5,958,103.18
Te Hyrat nga shitja e pasurise	34,772.39
Te Hyrat nga shitja e pasurise	41,777.00
<b>Totali I të hyrave</b>	<b>6,034,652.57</b>

## Pasqyra e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme

Pasqyra e pranimeve dhe pagesave të parave të gatshme për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror  
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor

Shënim	2023	2023 -1	2023 -2
	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit	Llogaria e vetme e Thesarit
	BKK '000	BKK '000	BKK '000
<b>BURIMET E FONDEVE -PRANIMET</b>			
Granti qeveritar	1,740.96	1,453	1,172.00
Të hyrat vetanake			
Të hyrat e dedikuara	4,812.20	4,069	4,231.00
Grantet e përcaktuara të donatorëve			
Financimet nga huamarrja			
Klauzola e investimeve			
Fondi zhvillimor në mirëbesim			
Pranimet tjera			
<b>Gjithsej</b>	<b>6,553.15</b>	<b>5,521.89</b>	<b>5,403.00</b>
<b>SHFRYTEZIMI I FONDEVE - PAGESAT</b>			
<b>Operacionet</b>			
Paga dhe shtesa	2 3,237.13	2,911.55	2,854.21
Mallra dhe shërbime	3 1,020.17	1,179	1,030
Shpenzime komunale	4 104.39	92.62	84
	<b>4,361.70</b>	<b>4,182.89</b>	<b>3,968.36</b>
<b>Transferet</b>			
Transfere dhe subvencione	5		
<b>Shpenzime kapitale</b>			
Prona, ndërtesa dhe pajisje	6 2,191.46	1,339.00	1,434.75
Pagesa tjera	7		
<b>Gjithsej</b>	<b>6,553.15</b>	<b>5,521.89</b>	<b>5,403.11</b>

Gjate vitit 2023 në kategorinë e Shpenzimeve Kapitale janë përfshirë edhe shpenzime në vlerë prej 793,072.83 Euro të cilat janë tërhequr nga Thesari me Urdhër përmbartimor, të Gjykatës Themelore Dega – Lipjan, lënda Cp.Nr. 47/2023. Nga kategoria Paga dhe Shtesa në vlerë prej 338,738.46 janë bartur shpenzime nga fondi burimor 23 në fondin 10. Ndërsa të kategoria Mallra edhe Shërbime është përfshirë vlera 132,875.63 Euro të cilat janë tërhequr nga Thesari me urdhër përmbartimor të lëndës me nr. CP. Nr. 124/2023.

## Raporti i ekzekutimit të buxhetit

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror  
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023

Shënime	2023				2023-1	2023-2
	Realizimi	Buxheti final	Buxheti fillestar	Ndryshimi	Realizimi	Realizimi
	A € '000	B € '000	C € '000	D=B-A € '000	E € '000	F € '000
<b>HYRJA E PARASË SË GATSHME</b>						
Të hyrat tatimore	8			-		
Të hyrat jo tatimore	9	77		(77)		
Të hyrat e dedikuara	10	5,958	5,500	(458)	5,888	4,645
Grantet e përcaktuara të donatorëve	11			-		
Tjera	12			-		
<b>Gjithsej Pranimet</b>		<b>6,035</b>	<b>5,500</b>	<b>(535)</b>	<b>5,888</b>	<b>4,645</b>
<b>DALJA E PARASË SË GATSHME</b>						
Paga dhe shtesa	2	3,237	3,237	2,898	-	2,912
Mallra dhe shërbime	3	1,020	1,650	1,650	630	1,179
Shpenzime komunale	4	104	162	162	58	93
Transfere dhe subvencione	5				-	
Shpenzime kapitale	6	2,191	2,522	2,522	330	1,339
Rezerva					-	
Tjerat	7				-	
<b>Gjithsej pagesat</b>		<b>6,553</b>	<b>7,571</b>	<b>7,233</b>	<b>1,018</b>	<b>5,522</b>

**Shënim:** Tek hyrja e parasë së gatshme, kemi dy të hyra jo tatimore nga shitja e pasurisë në vlerën 76,549.39 euro.

### Shënim 2 deri 12 Prezantim i ndryshimeve materiale

Për dallim prej shënimeve 2 deri 12, këto shënime përdoren për të sqaruar dallimin **material** në kolonën D (neni 14), domethënë dallimin material të realizimit të buxhetit. SNKSP në bazë të parasë se gatshme kërkon të sqarohen dallimet materiale. Varësisht nga madhësia e dallimit, nuk kanë nevojë të ofrohen shpjegime për të gjitha kategoritë, andaj mund të kërkojnë ndryshime në sistemin e numërimit të shënimeve. Kur të sqarohen dallimet e ndonjë kategorie të ndarjes, duhet të jepet përmbledhja e natyrës ndryshimit.

**Shpalosja e ndarjeve fillestare dhe finale të buxhetit**

Kategoria e ndarjes	Ndryshimet e autorizuara nga LMFP								Buxheti përfundimtar SIMFK € '000	Ndryshimet e buxhetit fillestar € '000
	Buxheti Fillestar (Ligji i Buxhetit) € '000	Ndryshimi I € '000	Ndryshimi II € '000	Ndryshimi III € '000	Ndryshimi IV € '000	Të hyrat vetanake € '000	Grantet e përcaktuara të donatorëve € '000	Burime tjera të financimit € '000		
<b>Hyjjet</b>										
Të hyrat tatimore									-	#DIV/0!
Të hyrat jo tatimore									-	#DIV/0!
Të hyrat e dedikuara	5,500								5,500	0
Grantet e përcaktuara të donatorëve									-	#DIV/0!
Huamarrjet									-	#DIV/0!
Tjeter									-	#DIV/0!
<b>Gjithsej</b>	<b>5,500</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>5,500</b>	<b>0</b>
<b>Daljet</b>										
Paga dhe shtesa	2,698		339						3,237	0.116871128
Mallra dhe shërbime	1,650								1,650	0
Shpenzime komunale	162								162	0
Transfere dhe subvencione									-	#DIV/0!
Shpenzime kapitale	2,522								2,522	0
Rezerva										#DIV/0!
Kësimi i huamarrjeve									-	#DIV/0!
Tjeter									-	#DIV/0!
<b>Gjithsej</b>	<b>7,233</b>	<b>0</b>	<b>339</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>7,571</b>	<b>4.7%</b>

**Shpalos në detaje shënimet në tabelë:**

Me Ligjin e buxhetit Nr. 08/L-193 për vitin 2023, Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror-ASHNA-së, ndarje të mjeveve financiare për vitin 2023 i janë bërë në total 7,232,550 €.

Në kategorinë Paga dhe Shtesa, Qeveria e Republikës së Kosovës ka bërë harmonizimin e pagave, ku është rritur buxheti për këtë kategori në vlerë prej 338,738.46.

**Shënimi 2 Paga dhe shtesa**

Përshkrimi	2023									2023-1 € '000	2023-2 € '000	
	Gjithsej								Buxheti			Ndryshimi
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000			Buxheti - Pagesat € '000
Pagat neto përmes listave të pagave	2,622				339		2,284		2,622	-	2,421	2,371
Pagesa për sindikate	3						3		3	-	8	11
Anëtarësim - oda e infermierëve të Kosovës	-								-	-		
Anëtarësim - oda e mjekëve të Kosovës	-								-	-		
Shtesat dhe kompensimet tjera	-								-	-		
Mëditjet për delegat dhe komisione	-								-	-		
Punëtorët me kontrate (jo në listën e pagës)	-								-	-		
Tatimi ndalor në të ardhurat personale	229						229		229	-	205	200
Kontributi pensional - punëtori	150						150		150	-	139	136
Kontributi pensional - punëdhënësi	150						150		150	-	139	136
Pagesa për vendime gjyqësore	82						82		82			
<b>Paga dhe shtesa</b>	<b>3,237</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>339</b>	<b>-</b>	<b>2,898</b>	<b>-</b>	<b>3,237</b>	<b>100%</b>	<b>2,912</b>	<b>2,854</b>

**Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:**

N Në kategorinë Paga dhe Shtesa, shpenzime të periudhës Janar-Dhjetor 2023 gjithsej kemi 3,237,131.16 ndërsa të planifikuara 2,898,393.00 dhe në Dhjetor 2023 ASHNA ka pranuar grant qeveritar në këtë kategori 338,738.46 €.

Paga Neto përmes listës se pagave..... 2,622,455.23  
 Pagesa për sindikate..... 3,402.04  
 Tatimi i ndalor në të ardhura personale..... 228,542.40  
 Kontributi pensional-punëtori..... 150,232.29  
 Kontributi pensional-punëdhënësi..... 150,232.29  
 Pagesa për vendime gjyqësore.....82,266.91  
 Realizimi i buxhetit te kjo kategori gjatë vitit fiskal 2023 është 3,237,131.16.

Mallra dhe shërbime

Kategoria	2023										2022	2021
	Qëllimi											
	Qëllimi	TE	N	VEH	QJ	TEV	TEP	QPD	Shë	Qëllimi		
€000	€000	€000	€000	€000	€000	€000	€000	€000	€000	€000	€000	€000
Sqarimet e kontraktave të punës	836					836			8	43	463	411
Mbledhjet e shërbimeve të punës	500					500			2	88	477	220
Allokimet e shërbimeve të punës	338					338			3	100	460	417
Sqarimet për shërbime të punës	47					47			1	57	174	128
Sqarimet për punë	-					-			-	-	-	60
Sqarimet e shërbimeve të punës	128					128			1	11	111	66
Sqarimet për punë	63					63			1	65	65	64
Sqarimet për shërbime të blerjes së punës	100					100			3	47	151	119
Shërbime të punës të punës	1200					1200			30	300	1204	1100
Shërbime të shërbimeve të punës	300					300			8	30	300	23
Shërbime të shërbimeve të punës	14					14			4	60	117	14
Shërbime të shërbimeve të punës	23					23			10	33	46	110
Shërbime të shërbimeve të punës	117					117			2	67	11	24
Shërbime të shërbimeve të punës	107					107			1	10	142	14
Shërbime të shërbimeve të punës	100					100			100	-	10	0
Punë të punës	100					100			7	14	-	-
Shërbime të shërbimeve të punës	-					-			-	-	4	1
Punë të punës	100					100			7	10	7	1
Punë të punës të punës (përfshirë)	100					100			1	60	4	1
Punë të punës të punës	60					60			1	60	7	-
Punë të punës të punës	100					100			4	10	1	1
Shërbime të punës	0					0			2	11	11	0
Shërbime të punës	100					100			1	60	1	1
Sqarimet të punës	40					40			4	60	1	7
Të punës	60					60			1	60	0	0
Mbledhjet e shërbimeve të punës	70					70			4	30	24	1
Mbledhjet e shërbimeve të punës	100					100			1	100	8	1
Sqarimet të shërbimeve të punës	170					170			10	70	10	24
Mbledhjet e shërbimeve të punës	140					140			10	100	14	10
Mbledhjet e shërbimeve të punës	100					100			0	40	11	1
Mbledhjet e shërbimeve të punës	100					100			0	21	0	0
Sqarimet të shërbimeve të punës	100					100			1	100	0	0
Shërbime të punës	100					100			1	100	1	0
Shërbime të punës	100					100			1	100	1	1
Vitet	100					100			7	40	1	1
Vitet të punës	100					100			-	100	1	1
Mbledhjet e shërbimeve të punës	100					100			100	0	100	100



**Shpalos në detaje shënimet në tabelë:**

- Shpenzime në total te kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve janë 1,020,174.16 dhe më poshtë kemi dhënë shpalosjen në detaje e shënimeve të paraqitura në tabelë dhe janë të ndara sipas nënkategorive të paraqitura në PCF4:

**Shpenzimet e udhëtimit.**

- Shpenzimet e planifikuara dhe të kërkuara për udhëtime zyrtare për vitin 2023 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, kanë qenë kryesisht shpenzime jashtë vendit. Ato janë të bazuara në kërkesat dhe nevojat e Departamenteve të ASHNA-së të cilat kanë karakter trajnimi, shkollimi, prezantimi, promovimi, aftësimi dhe shkëmbimi të përvojave si dhe pjesëmarrjes në konferenca të ndryshme rajonale dhe botërore të aviacionit për nevojat ASHNA-së.

**Shërbimet për telekomunikim**

Shpenzimet për shërbime të telekomunikimit të ndodhura janë sipas zërave të shpenzimeve të paraqitura si më poshtë:

- Interneti shfrytëzohet për nevoja të ASHNA-së
- Shpenzime e telefonisë mobile të cilat janë në shfrytëzim të personelit të ASHNA-së sipas aprovimeve për shpenzime,
- Shpenzime postare, ku ASHNA shfrytëzon këtë linjë buxhetore për nevoja të dërgesave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit,
- Shpenzimet për përdorim të kabllit optik, ASHNA shfrytëzon këtë linjë për qëllime dhe nevoja të veta si Linjat e dedikuara për ASHNA-në për pajisjet e navigimit ajror si dhe pajisjeve tjera të teknologjisë informative.

**Shpenzimet për shërbimet.**

- Shpenzimet më të larta paraqitura janë shërbimet për trajnime ku marrin shumën kryesore të kësaj kategorie ekonomike në të cilën janë trajnimet e rregullta për mbajtje të licencave dhe kompetencës, siç është e rregulluar përmes Rregulloreve në fuqi të Autoritetit të Aviacionit Civil. Në këtë kategori janë përfshirë edhe shërbimet për shtypje të librarive të ndryshme për nevojat operacionale, si harta dhe raporte të ndryshme, printimet e dokumenteve të përditshme, të cilat janë me kontrata në nivel vendi etj. Shpenzimet tjera kontraktuese përfshijnë, shpenzimet e dezinfektimit dhe shpedicionit si dhe shpenzimet për shërbimet e AFTN(shërbime të dërgimeve të mesazheve aeronautike) të cilat merren nga ISAVIA, ndërsa të shpenzimet për shërbimet teknike janë të përfshira tarifata dhe certifikimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës si dhe licencat vjetore nga Eumetsat dhe ARKEP. Te shpenzimet për anëtarësim është paraqitur shumica e shpenzimeve të tarifës vjetore të anëtarësimit në Organizatën Civile për Shërbimet e Navigacionit Ajror (CANSO). Shërbime konsulente, Quality Management system me ISO 9001/2015, Environment Management System, Iso 14001/2015, Occupational Health Management Systems OHSAS 18001 / 2017.

**Mobile dhe pajisje me vlerë më të vogël deri në 1000€.**

- Në këtë nënkategori janë të paraqitura shpenzimet e për pajisjet e sigurimit dhe pajisjeve të tjera si dhe mjete të tjera sipas nevojës për njësitë mbështetëse. Janë po ashtu blerjet tjera të inventarit të imët për zyre nga Departamentet e ASHNA-së të cilat nuk i përkasin kategorisë së kapitaleve.

**Blerje të tjera të mallrave dhe shërbimeve.**

- Në këtë linjë janë të paraqitura shpenzimet për furnizimin e zyrave, si furnizim për material të zyrave, shpenzimeve për furnizim me ushqim dhe pije, kemi paraqitur shpenzimet e furnizimit me ujë për stafin e ASHNA-së si dhe pije për sallat e takimeve në ASHNA për raste të pritjes së palëve. Në furnizimet për higjienë janë të përfshira shpenzimet e materialit higjienik për pastrimin e hapësirave të ASHNA-së, veshmbathje për stafin operativ të Sigurim & Teknik (veshje për teren), të cilat shfrytëzohen për nevoja të ASHNA-së.

**Derivatet dhe lëndët djegëse.**

- Në këtë linjë janë të përfshira të gjitha shpenzimet që janë të lidhura me furnizimin me derivate të naftës e që ASHNA ka për vetura zyrtare, për gjenerator në lokacionet ku janë të vendosura pajisjet dhe objekti si dhe vaj për pajisje të navigacionit ajror.

**Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve**

- Në mjetet e planifikuara për këtë konto janë të përfshira shpenzimet e kontraktuara me tenderim për sigurimin e operimeve të ASHNA-së, që kërkohet nga AACK për ofrim të shërbimeve, sigurimin e aseteve të ASHNA-së si dhe sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve në shfrytëzim të ASHNA-së.

**Mirëmbajtja dhe riparimi**

- Në këtë linjë janë të përfshira shpenzimet e mirëmbajtjes së automjeteve operative dhe administrative të ASHNA-së, mirëmbajtjet e ndërtesave të ASHNA-së, mirëmbajtja e pajisjeve të teknologjisë informative, mirëmbajtjet për sistemet e navigacionit ajror, mirëmbajtjet e gjeneratorëve, mirëmbajtjet e rrjetit elektrik brenda hapësirave të ASHNA-së, mirëmbajtja e kondicionerëve të ajrit, liftit, mirëmbajtja e softuerit Navision si dhe kalibrimi i pajisjeve të navigacionit nga ajri proces që kryhet dy herë brenda vitit, mirëmbajtja e objekteve të ASHNA-së brenda dhe jashtë, mirëmbajtja e radarit të menaxhuar nga stafi dhe kontraktore prodhues (kërkesë e rregullatorit (AAC, EASA...)).

**Shpenzimet e marketingut**

- Paraqitja e këtyre shpenzimeve të marketingut është në bazë të kërkesave dhe nevojave të njësive organizative për vitin 2023. Në këtë kategori të shpenzimeve bëjnë pjesë: konkurset e ndryshme për nevoja të ASHNA-së, botimet e broshurave udhëzuesve, informatorëve të ndryshëm etj.

**Vendime Gjyqësore**

- Tek vendimet gjyqësore kemi tërheqjen e mjeteve në vlerë 132,875.63 të urdhrin përbarimor të lëndës me nr. CP. Nr. 124/2023.

**Shpenzime komunale**

Përshkrimi	2023										2023-1 € '000	2023-2 € '000
	Gjithsej								Buxheti	Ndryshimi Buxheti -		
	Pagesat € '000	FH € '000	KI € '000	FZHM € '000	GQ € '000	THV € '000	THD € '000	GPD € '000	Final € '000	Pagesat € '000		
Rryma	79					79			130	51	71	64
Uji	1							1	2	1	1	1
Mbeturinat	1							1	3	2	0	0
Ngrohja Qendrore	11							11	20	9	11	10
Shpenzimet telefonike	13							13	7	(6)	10	9
Pagesa-vendimet gjyqësore												
Pagesa -Neni 39.2 LMFPF	-											
<b>Shpenzime komunale</b>	<b>104</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>104</b>	<b>-</b>	<b>162</b>	<b>58</b>	<b>93</b>	<b>84</b>

Gjate vitit 2023 në kategorinë e Shpenzimeve Kapitale janë përfshirë edhe shpenzime në vlerë prej 793,072.83 Euro të cilat janë tërhequr nga Thesari me Urdhër përmbarimor, të Gjykatës Themelore Dega – Lipjan, lënda Cp.Nr. 47/2023.

**Të hyrat e dedikuara**

Përshkrimi	2023			2023-1	2023-2	% e totalit 20__	% e ndryshimit nga 20__-1
	Shënim e	€ '000	€ '000	€ '000	€ '000		
Lloji i të hyrës 1		5,958.10	5,887.68	4,645.00			
Lloji i të hyrës 2						%	%
Lloji i të hyrës 3						%	%
Lloji i të hyrës 4						%	%
<b>Gjithsej</b>		<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0%</b>	<b>%</b>

**Shpalos në detaje shënimet e pasqyruara në tabelë:**

Të hyrat e ASHNA-së krijohen në bazë të dhënies së shërbimeve për shfrytëzuesit e tyre ku tarifohen për këto shërbime në bazë të Ligjit Nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror të Republikës së Kosovës, dhe menaxhohen në bazë të LMFPF. Të hyrat e ASHNA-se përbëhen nga : Tarifat e shfrytëzuesve të vlerësuara dhe të mbledhura nga ASHNA dhe Donacionet, grantet dhe çdo mbështetje tjetër financiare ose teknike e dedikuar për ASHNA-në.

Të dhënat e paraqitura në Shënimin 10 të hyrat e dedikuara janë sipas ofrimit të shërbimeve gjatë vitit fiskal 2023 ku në total të hyra gjatë vitit 2023 janë 5,958,103.18 EUR.

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2023

Të arkëtueshmet

Kodi ekonomik	Përshkrimi	2023	2023-1	2023-2
	50401 Shitja e Shërbimeve	388,158.07	426,366.56	884,378.30
<b>Gjithsej</b>		<b>388,158.07</b>	<b>426,366.56</b>	<b>884,378.30</b>

Data e lëshimit te fatures	Numri i faturës	Kodi ekonomik	Afati i pagesës	Furnitori	Përshkrimi	2023
21.04.2022	00001/2023	50401		HUNGARO CONTROL	VAT for the Multiplexer tybe UMUX 15000 based on amandament nr 1	5,674.52
19.10.2023	00006/2023	50401		HUNGARO CONTROL		12,501.00
05.12.2023	00014/2023	50401		Limak	Air Grond Cunnunication serice 01.07.2023-30.09.2023 Shërbimet e Approachfee Nentor 2023	369,982.55
<b>Gjithsej</b>						<b>388158.07</b>

Detyrimet (faturat) e papaguara

Kategoria Ekonomike	Kategoria ekonomike	2023		2023-1		2023-2	
		< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë	< 30 ditë	> 30 ditë
11	Paga dhe shtesa						
13	Mallra dhe shërbime	42.40				1,525	
14	Shpenzime komunale	84.15					
20	Transfere dhe subvencione						
30	Shpenzime kapitale					41,346	
<b>Gjithsej</b>		<b>126.55</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>42871.49</b>	<b>0</b>

**Detyrimet kontingjente**

<u>Kategoria ekonomike</u>	<u>Kategoritë ekonomike</u>	<u>2023</u>	<u>2023-1</u>	<u>2023-2</u>
11	Paga dhe shtesa	86,581.15	650,532.48	549,249.40
13	Mallra dhe shërbime	60,000.00		
14	Shpenzimet komunale			
20	Subvencione dhe Transfere			
30	Shpenzimet kapitale	701,374.82		
<b>Gjithsej</b>		<b>847,955.97</b>	<b>650,532.48</b>	<b>549,249.40</b>

**Detyrimet kontingjente të ASHNA-së të vlerësuara:**

- Lënda e paditësit Dritëro Zhtija dhe nëpunësve të tjerë në Gjykatën e Apelit C.nr 196/18, kontest pune, për kompensim në vlerë 86,581.15 Euro.
- Lënda e paditësit Hilmi Mehiu në Gjykatën Themelore të Prishtinës -dega në Lipjan me Nr. C.nr 207/2015, kontest në vlerë 60,000.00 euro kompensim për aksidentin e tij në Cargo të ANP "Adem Jashari" nga viti 2009.
- Lënda në procedurë përmbartimore P.nr 197/23 Raif Shala, kontest për kompensim në vlerë 148,811.56,
- Lënda me N.nr 188/2005 nga paditësi Latif Shala, Kompensim pronësor në vlerë 144,569.00 euro.
- Lënda me Nr. C.nr 10/2021 Shaip Seferi kompensim dëmi në fitimin e humbur nga pamundësia e shfrytëzimit të pasurisë (tokës) në afërsi të ANP "Adem Jashari". Kontest për kompensim në vlerë 14,000.00, vlerë e përcaktuar sipas ekspertizës.
- Lënda me Nr. C.N 2462/2015 Murat Sogojeva etj, kompensimi i fitimit të humbur nga pamundësia e shfrytëzimit të pasurisë (tokës) në afërsi të ANP "Adem Jashari". Kontest për kompensim në vlerë 59,594.26 euro.

Lëndët në procedurë gjyqësore në Gjykatën Themelore të Prishtinës – dega Lipjan, për pronat e pa kompensuara e të shpronësuara me vendimet e Kuvendeve Komunale të Lipjanit Nr .785-449 të datës 18.12.2003 dhe të Fushë Kosovës me Nr. 58. të datës 01.06.2004, si në vijim:

- Ramadan Osmani, kompensim prone me sipërfaqe prej 0.12 Ha, në vlerë 94,400.00 Euro;
- Dragan Sologub, kompensim prone me sipërfaqe 0.50 Ha, në vlerë 240,000.00 Euro
- Gjithsej: 334,400.00 € për eksproprijim/shpronësim.

**Pasuritë kapitale (me vlerë mbi 1000 Euro)**

Klasifikimi i pasurive	<u>2023</u>	<u>2023-1</u>	<u>2023-2</u>
Ndërtesa	479,221.77	239992.7	246351.48
Toka			
Pajisjet	2,400,714.15	465,342.32	220951.95
Infrastruktura	10789.69		
Makineria	173,438.72	843,590.48	1,518,564.87
Automjetet	32,926.69	46,994.67	61,062.65
Tjera	<u>1,768,462.85</u>	<u>2,896,388.80</u>	<u>4,086,211.49</u>
Gjithsej	<u><u>4,865,553.87</u></u>	<u><u>4,492,308.97</u></u>	<u><u>6,133,148.44</u></u>

Raport për gjendjen/zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA)

Nr	Rekomandimi	Veprimi i ndërmarrë	Afati i zbatimit	Statusi aktual i rekomandimit	Vlerësimi i rrezikut
1	Rekomandimi A1 - Drejtori duhet të sigurojë se para lidhjes së kontratës është bërë një vlerësim i mirë i afatit të kohëzgjatjes së saj, me qëllim që të gjitha furnizimet të bahen brenda afatit të paraparë. Gjithashtu të kërkoj nga zyrtarët përgjegjës zbatimin e procedurave, duke filluar nga iniciu i shpenzimeve deri në kryerjen	Gjatë vitit vitit 2023 janë njoftuar zyrtarët për afatet e pagesave brenda afatit të kontratës dhe që t'i kushtohet vëmendje procedurave në iniciu dhe përfundimin e pagesave.	Korrik-Dhjetor 2023	I përmbushur	Prioritet i lartë
2	Rekomandimi B1 - Drejtori duhet të sigurojë se të gjitha obligimet/faturat të paguhen brenda afatit prej 30 ditëve pas pranimit të faturave.	Janë njoftuar zyrtarët me rregulloren përkatëse në mënyrë që të gjitha obligimet / faturat të paguhen brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. është rritë niveli kontrolloti të brendshëm në mënyrë që mos të paraqiten vonesa në pagesa.	Korrik-Dhjetor 2023	I përmbushur	Prioritet i lartë
3	Rekomandimi B2 - Drejtori duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që shpenzimet të planifikohen në ndajet adekuat të buxhetit apo të bëhet rideditim i mjeteve dhe që realizimi i pagesave të bëhet në kategorinë adekuat për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël.	Gjatë procesinut të transaksioneve është siguruar që mos të aprovohen shpenzimet që nuk i takojnë kategorisë përkatëse sipas natyrës së shpenzimit. është shpërndarë Udhëzimi Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël tek të gjithë menaxherët që janë pjesë e hartinut dhe projeksioneve buxhetore të dala si rezultat i nevojave dhe kërkesave dhe buxhetore.	Korrik-Dhjetor 2023	I përmbushur	Prioritet i lartë
4	Rekomandimi A2 - Drejtori duhet të sigurojë se pasuritë të cilat janë pranuar dhe janë në përdorim, të evidentohen në regjistrin e pasurisë si pasuri në përdorim duke aplikuar edhe shpenzimet e zhvlerësimit, me qëllim të paraqitjes së drejtë të vlerës së tyre në PVF.	Ky rekomandim tanimë është adresuar dhe janë marr veprime dhe pas përmbylljes së projekteve të gjitha investimet në vijim janë kthyer në investim të rregullt.	Prill-Maj 2023	I përmbushur	Prioritet i lartë
5	Rekomandimi A3 - Drejtori duhet të marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të funksionalizuar sistemin e pasuria duke i evidentuar dhe mirëmbajtur pasuritë nën 1,000€ dhe stoqet. Po ashtu duhet të sigurojë se në fund të çdo viti bëhet inventarizimi i pasurisë në mënyrë që të sigurohet një gjendje e saktë dhe e drejtë e regjistrit të pasurisë.	Gjatë vitit 2023 është themeluar Komisioni për Inventarizimin e pasurisë dhe zyrtarët e pasurisë kanë bërë ndryshimet e nevojshme në evidentimin e pasurive sipas rezultati të raportit nga komisioni i inventarizimit gjithashtu edhe sistemin e pasurisë është funksionalizuar nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme, ku zyrtari i pasurisë në bashkëpunim me zyrtarët përgjegjës të sistemit e-pasuria janë në proces të regjistrimit	Korrik-Dhjetor 2023	I përmbushur	Prioritet i lartë

## Menaxhimi i Rreziqeve të Organizatës

Për menaxhimin e rreziqeve të organizatës, ASHNA ka miratuar dokumentin Menaxhimi i Rrezikut, përmes të cilit identifikon rreziqet të cilat mund të kenë ndikim në arritjen e objektivave të saj.

Ky dokument është krijuar bazuar në kornizën ligjore në fuqi dhe azhurnohet në baza vjetore apo më shpesh nëse ka nevojë.

Në vijim do paraqesim disa nga rreziqet kryesore të identifikuara përmes këtij procesi për vitin 2024

- Mos-Anëtarësimi në institucionet relevante ta aviacionit civil;
- Menaxhimi i kodit "Indikatorit i lokacionit BKPR" që varet nga ICAO dhe partneri komercial Islandez;
- Mungesa e të hyrave nga hapësira e lartë ajrore
- Konkurrenca në tregun rajonal;
- Forcat madhore;
- Pandemitë;
- Mungesa e FIR/e kodit të FIR;
- Largimi i numrit të madh të stafit kyç me aftësi, njohuri dhe eksperiencë relevante




## Burimet Njerëzore

### Personeli i ASHNA-së


Periudhën raportuese 01 janar 2023 – 31 dhjetor 2023, ASHNA e përmbyll me gjithsejt 162 nëpunës. Gjatë muajit nëntor 2023, një nga nëpunësit e Departamentit Meteorologjik është pensionuar, ndërsa një punonjëse është larguar me vendim të Komisionit Disiplinor dhe konfirmim nga Komisioni i Ankesave.




Personeli sipas gjinisë në përqindje



Kualifikimet e personelit



Profili i moshës së nëpunësit



Etniciteti i nëpunësve

## Rekrutimi

Në vitin 2023 nuk është realizuar asnjë proces i rekrutimit në ASHNA për shkak të proceseve të varura edhe nga faktorë të jashtëm, përkundër planifikimeve”

Procesi i rekrutimit i planifikuar për Kontrollor të rinjë të Trafikut Ajror nuk ka ndodhur meqë ishte i ndërlidhur me procesin e tenderimit të Sistemit ATM, projekt që ka filluar së implementuari në vjeshtë të vitit 2023 dhe si rrjedhojë rekrutimi është shtyrë për vitin 2024, kur do të rekrutohen 24 student kontrollorë të trafikut ajror në 2 faza.

## Rishikimi i Rregulloreve dhe Manualeve që ndërlidhen me fushën e Burimeve Njerëzore

Gjatë vitit 2023 kemi filluar dhe udhëhequr procesin e përpilimit të Ligjit të ri për ASHNA. Fillimisht me përgatitjen përmes grupit të Koncept Dokumentit, i cili pas miratimit nga ana e qeverisë është kaluar në draft

imin e projektligjit për ASHNA, i cili pritet të miratohet dhe hyjë në fuqi gjatë vitit 2024. Si rrjedhojë ASHNA pritet që në procesin e miratimit të ligjit të ri të përgatitet edhe me adaptimin dhe miratimin e akteve tjera nënligjore.

### Ligji i pagave dhe Ligji për Zyrtarët Publik

Viti 2023 ka qenë mjaft sfidues në raport me ndryshimet ligjore që kanë ndodhur në nivel qendror. Ligji i Pagave në Sektorin Publik Nr. 08/L-196 ka hyrë në fuqi nga Shkurti 2023. Parregullsitë në pozicionimin e personelit të ASHNA-së në këtë ligj kanë sjellë paqartësi dhe pasiguri për personelin tonë, me ç'rast ASHNA ka reaguar konform kompetencave të veta përmes shkresave zyrtare në DMZP (Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik) në lidhje me korrigjimin adekuat dhe të përshtatshëm në kuadër të dispozitave të këtij ligji. Po ashtu DBNJ e ASHNA-së ka pasur disa takime zyrtare me DMZP gjatë vitit 2023 në lidhje me këtë çështje dhe viti ka përfunduar me paqartësitë në evitimin e diskrepancave të paraqitura në pagesat e personelit që nuk ishin në përputhje me doktrinën "punë e njëjtë, pagë e njëjtë". ASHNA nuk ka qenë e involvuar në draftimin e këtij ligji meqë është punuar paraprakisht në draftimin e ligjit të ri për ASHNA që do të duhej të linte ASHNA-në jashtë ligjit për pagat në sektorin publik dhe ligjit për zyrtarët publik.

Po ashtu edhe hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrtarët Publikë, Ligji Nr. 08/L-197, që ka ndodhur në 3 mujin e fundit të 2024, i reviduar me vendimin e Gjykatës Kushtetuese, ka sjellur situata të paqarta në lidhje me menaxhimin e personelit dhe disa herë kemi kërkuar interpretime dhe sqarime ligjore nga vetë DMZP, me qëllim të zhbllokimit të proceseve.

### Ngritja dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Në kuadër të kapaciteteve të zhvillimit të burimeve njerëzore në Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) duke qenë një aspekt kyç për t'u siguruar që personeli të ketë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre me sukses, ka përfshirë elementet në vijim:

- Identifikimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave të nevojshme për të përmbushur qëllimet e ASHNA-së dhe detyrat specifike të personelit.
- Sigurimi i programeve të trajnimit të përshtatshme për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e personelit, duke përfshirë trajnime teknike dhe zhvillim profesional.
- Sigurimi i një procesi të përshtatshëm për vlerësimin e performancës së punonjësve dhe ofrimin e feedback-it konstruktiv, që ndihmon në identifikimin e nevojave për zhvillim të mëtejshëm.

Në këtë menyrë, Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ka mundur të ndërtojë dhe të ruajë kapacitetet e zhvillimit të burimeve njerëzore për të siguruar që punonjësit kanë aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të përmbushur misionin dhe vizionin me sukses.

Ndërsa, për vitin 2024, fokusi i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA) do të jetë trajnimi/përgatitja e 12 kontrollorëve të rinj të trafikut ajror. Kjo është pjesë e strategjisë së ASHNA-së për të rritur kapacitetin dhe aftësitë e personelit të trafikut ajror për të përballuar rritjen e volumit të trafikut, për të siguruar një nivel të lartë të sigurisë dhe efikasitetit në zonen ajrore që këta kontrollorë mbulojnë si dhe për t'u përgatitur për menaxhimin e hapësirës së lartë, që shpresojmë se do të ndodhë në një të ardhme të afërt.

### Sigurimet shëndetësore

Në gusht të vitit 2023 përmes procedurave të prokurimit është bërë sigurimi shëndetësor për të gjithë punonjësit e ASHNA-së. Kontrata e sigurimit shëndetësor është nënshkruar me kompaninë ELSIG.

### Priroritetet për 2024

Në Planin e Performancës për vitin 2024, planet e biznesit dhe në të gjitha planifikimet tjera përkatëse për vitin 2024, ASHNA ka përcaktuar dhe vendosur objektivat kryesore, përkatësisht priroritetet e saj.

- **NORMALIZIMI I HAPËSIRËS AJRORE**
  - ✓ Hapësira e ulët - hapja e pikave dhe rrugëve ajrore me malin e zi
  - ✓ Hapësira e lartë – përgatitja e personelit
- **IMPLEMETIMI I SISTEMIT ATM**
- **KALIMI NË ENERGJI TË RIPËRTËRITSHME “GREEN”**
- **“UPGRADE” I MSSR - IT TË GOLESHIT**
- **ÇERTIFIKIMI ISO**

